



VENDIM MBI PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 10 nëntor 2014

Numri i lëndës: 2014-28

Selatin Fazliu

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 16 prill 2014.

II. THE FACTS

2. Ankuesi pohon se që nga viti 1951 janë përvetësuar disa hektarë tokë që i përkasin familjes së tij në vende të ndryshme në gjithë Kosovën, përfshirë edhe në Prishtinë.
3. Ankuesi pohon se familja e tij ka qenë e diskriminuar nga autoritetet jugosllave dhe se *“familja e tij është vrarë nga ky regjim dhe se pronat e mija dhe pronat e familjes janë marrë dhe i janë dhënë malazezëve, në mënyrë që të popullohet ky vend me jo-shqiptarë”*.
4. Ankuesi gjithashtu parashtrohet një letër përgjigje nga ana e zyrës së shefit të stafit të EULEX-it të datës 5 shtator 2012, në të cilën ankuesi informohet se pasi që ai nuk kërkon të ndërmerret ndonjë veprim i caktuar, EULEX-i nuk është në gjendje të merr masa lidhur me letrën e tij dërguar përmes postës elektronike.

III. ANKESAT

5. Ankuesi kërkon të zgjidhet lënda e tij dhe pronat e tij t'i kthehen atij nga Paneli.

II. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli konkludon nga informacioni i marrë se rasti i ankuesit ka të bëjë me uzurpim të pretenduar të pronës në vitet e 1950-ta.

10. Paneli nuk gjen ndonjë tregues se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet rreth të cilave është bërë ankesë (po ashtu krahasoni *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, në par. 9), e as nuk ka ndonjë dëshmi pranë Panelit se EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankuesit.
11. Gjithashtu, letër përgjigja e EULEX-it, e përmendur në par. 4 më lartë, nuk i ka mundësuar Panelit të ketë juridiksion për të shqyrtuar lëndën, pasi që EULEX-i nuk e ka ushtruar mandatin e tij ekzekutiv brenda kuptimit të Konceptit Llogaridhënës së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 rreth themelimit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (shih gjithashtu *Kadriu kundër EULEX-it*, 2013 -27, 27 maj 2014, në par. 18). Në asnjë rast, nuk ka ndonjë tregues se EULEX-i kështu ka shkelur të drejtat e ankuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se ankesa është e papabazuar në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese